



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

16 prill, 2020
Prishtinë

Ndonëse në kohë të pandemisë, ku në shoqërinë tonë është duke u rikonfirmuar roli dhe rëndësia e mjekut, por edhe e mediave, në raport me fenomenin më të çmueshëm natyror siç është jeta, sot disa media, ndoshta pa dashje, stigmatizuan fisnikërinë dhe figurën publike të MJEKUT. Këto medime, në kundërshtim me përmbajtjen e informatës, raportojnë për arrestimin e një personi nga Komuna e Gjilani, me ç'rast në tekstin e lajmit e pohojnë se nuk është mjek, por në mënyrë bombastike dhe tendencioze në titullin e lajmit e cilësojnë atë si mjek i cili është arrestuar për shkak të promovimit të kinse një medikamenti me bazë bimore për të shëruar infeksionin COVID 19.

Oda e Mjekëve të Kosovës, konsideron se bërja e gazetarisë së tillë është në kundërshtim me normat e etikës gazetareske dhe se një qasje e tillë, sidomos në kohën kur mjekët dhe i tërë personeli shëndetësor janë duke e rrezikuar jetën e tyre dhe të familjes duke u ballafaquar me një armik të padukshëm, me qëllim që të mbrohet jeta dhe shëndeti i qytetarëve. Në këtë kohë të ndjeshme dhe me plotë dezinformata sidomos në rrjetet sociale, jo rrallëherë demonizimi i figurës së mjekut përbën edhe rrezik ndaj sigurisë publike.

Oda e Mjekëve të Kosovës, kërkon nga mediat që menjëherë të bëjnë përmirësimin në titullin e këtij lajmi, kjo do të kontribuonte edhe më shumë korrektësisë dhe efikasitetit dhe pozitivitetit të shfaqur nga ana e mediave në këto ditë të vështira për shoqërinë kosovare.

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, m.f. Sci

